REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-428
Data / Datum / Date: 30 / 03 / 2026
Shtojca / Dodaci / Annex: -2-
PRISHTINË / A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr.47/2026
Datë: 30/03/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në bazë të nenin 10, 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) dhe nenin 15 të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 27, 28 dhe 31 (paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, 2.3 dhe paragrafi 3) të Rregullores Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj.Flutura Mehmeti, emërohet Asistente Administrative në Kabinetin e Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë.

2. E emëruara nga pika 1 e këtij vendimi do të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, dhe detyrat e tjera që i caktohen nga Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë.

3. Mandati i të emëruares në pikën 1 të këtij vendimi fillon me datë 30/03/2026 dhe zgjatë deri kur pushon mandati i Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë, përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.

4. Të ardhurat personale të të emëruares nga pika 1 e këtij vendimi do t'i paguhen sipas legjislacionit përkatës në fuqi për pagat.

5. Obligohet Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - QEVERIA E KOSOVËS - MINISTRIA E DREJTËSISË - KABINETI I MINISTRIT - REPUBLIKA KOSOVA - VLADA KOSOVA - MINISTARSTVO PRAVDE - URED - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRY OF JUSTICE - OFFICE OF THE MINISTER - PRISHTINË

Vendimi i dërgohet:

- *Të emëruares znj. Flutura Mehmeti;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*